

Kur flitet për përfaqësimin gjinor në procese politike në Kosovë, aty dominon tema e kuotës gjinore prej 30 % në institucione ligjvënëse, në nivel lokal dhe qendror. Kuota gjinore në institucionet ligjvënëse përdoret si arsytim që gratë kanë mjaftueshëm hapësirë në politikë dhe se Kosova s'mund të bëjë më shumë se kaq.

Megjithatë, kjo analizë shtjellon përfaqësimin gjinor në politikë përtej institucioneve ligjvënëse. Këtu analizohet hapësira e përfshirjes në degë ekzekutive, në pozita emëruese në degët ekzekutive ku vendimmarrja dhe pushteti është më i madh, sidomos në Kosovë, si dhe përfaqësimi gjinor në parti politike, të cilat janë përgjegjëse për emërimin e personave në këto poste politike.

Më tutje, kjo analizë e politikës publike ofron propozime konkrete për avancimin e politikave të përfaqësimit gjinor në degën ekzekutive në nivel qendror dhe lokal.

Inkurajuese në këtë kohë janë: së pari ka mjaft hapësirë në degë ekzekutive në dy nivelet për të avancuar përfaqësimin gjinor dhe së dyti Kosova aktualisht është në fazë të shqyrtimit të legjislacionit i cili mund të ndikojë në këtë drejtim.